10 PY. A keni dhënë një deklaratë në atë takim?

11 PË. Po.

12 PY. Dua të shikoni në fund të faqes në anglisht. A e njihni
13 nënshkrimin tuaj në fund të fare të faqes së parë?

14 PË. Po, është nënshkrimi im, e njoh.

15 PY. Kohët e fundit, a ju është dhënë mundësia që të bëni
16 sqarime dhe korrigjome lidhur me deklaratat e dhëna?

17 PË. Po, m'u dha kjo mendësi.

18 PY. A ju kujtohet që keni bërë disa sqarime dhe korrigjime
19 për këtë deklaratë?

20 PË. Po.

21 PY. A ju kujtohet që këto sqarime dhe korrigjime janë
22 përfshirë në një shënim që ju lexua ju më pas?

23 PË. Po.

24 PY. Duke marrë parasysh edhe korrigjimet dhe sqarimet që keni
25 dhënë, informacione që keni dhënë në këtë deklaratë që

Dëshmitari: Claude Cahn (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Shahabuddin

Faqe 114

1 shikojmë në ekran sot, dhe këto ndryshime dhe korrigjime, a
2 është kjo dëshmia e plotë dhe e saktë juaja?

3 PË. Po.

4 PY. Duke marrë parasysh sqarimet dhe korrigjimet që përmenda
5 pak më herët, së bashku me këto korrigjime, deklaratat që keni
6 dhënë a do të ishte pasqyra e plotë e asaj çfarë do të thoshit
7 sot në qoftë se do të pyeteshit për të njëjtat pyetje?

8 PË. Po.

9 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që
10 të kërkoj që të pranohen në prova materiale deklaratat e
11 mëparshme të dëshmitarit si dhe provat materiale shoqëruese.
12 Në qoftë se doni, mund të lexoj edhe numrat ERN të tyre.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
14 çaktivizuar]

15 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Dokumenti i parë është
16 034032 deri në 034057 RED3 si dhe 034032 deri në 034057-AT
17 RED3. Po ashtu dokumenti 120035 deri në 120038. Dokumenti
18 tjetër është SITF00265720 deri në 00265827 RED3, SITF00265828
19 deri në 00265846. Këto katër dokumente që sapo përmenda duhet
20 të klasifikohen si konfidencialë.

21 Dhe tani do të vazhdojmë me dokumentet e mbetura që
22 ndoshta do të ishte mirë që të klasifikoheshin si publike.

23 Këto janë dokumentet si më poshtë: 024835 deri në 024843,
24 024844 deri në 024865, 023821 023822, 023815 deri në 023820,
25 023795 deri në 023808

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
2 çaktivizuar]

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

4 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Jo, nuk kemi, përveç atyre
5 çfarë kemi paraqitur më përpara.

6 Z. TULLY: [Përkthim] [sipas përkthimit] Nuk kemi as ne
7 kundërshtime.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
9 çaktivizuar]

10 Dokumenti 034023 deri në 034057 RED3, plus dhe dokumentet
11 shoqëruese që u përmendën nga Prokurorja dhe Shënimi
12 Përgatitor nr. 1 -- nuk e di, e përmendët Shënimin Përgatitor
13 Nr. 1, Prokurore, apo jo?

14 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës,
15 është dokumenti i dytë. Ishte dokumenti 12035 -- 238 [Sipas
16 përkthimit].

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

18 Edhe Shënimi Përgatitor nr. 1 dhe të gjithë dokumentet e
19 tjera të cilat i përmendi me hollësi Prokurorja do të marrin
20 një nunër të provës materiale. Katër dokumentet e parë do të
21 klasifikohen si konfidencialë, ndërkohë që provat materiale
22 shoqëruese do të klasifikohen si publike.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
24 për deklaratën me numër 034032 deri në 034057 RED3 dhe
25 përkthimi në shqip, do të marrin numrin e provës materiale

1 P1047 dhe do të klasifikohen si konfidencialë.

2 Shënimi Përgatitor me numër ERN 120035 deri në 120038 dhe
3 -- i klasifikuar si konfidencial, do të marrë P1048.

4 Prova shoqëruese SITF00265720 deri në 00265827 RED3 do të
5 marrë numrin e provës materiale P1049. Do të klasifikohet
6 gjithashtu si konfidenciale.

7 Dokumenti SITF00265828 deri në 00265846 do të marrë
8 numrin e provës materiale P1050 dhe do të klasifikohet si
9 konfidencial.

10 Dokumenti tjetër është 024835 deri në 024843 do të marrë
11 numrin e provës materiale P1051 dhe do të klasifikohet si
12 publik.

13 Për dokumentin tjetër 024844 deri në 024865 do
14 klasifikohet gjithashtu si publik, dhe do të marrë numrin e
15 provës materiale P1052.

16 Më tej, dokumenti 023821 deri në 023822 do të
17 klasifikohet si publike, dej do t'i caktohet numri i provës
18 materiale P1053.

19 Dokumenti 023815 deri në 023820 do të marrë numrin e
20 provës materiale P1054. Do të klasifikohet si publik,
21 ndërkohë.

22 Dhe dokumenti i fundit, të nderuar Gjykatës, 023795 deri
23 në 023808 do të marrë numrin e provës materiale P1055 dhe do
24 të klasifikohen njësoj, si publike.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund

1 vazhdoni, Prokurore.

2 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me 14
3 mars të vitit 2024 ZPS-ja ka dorëzuar një përmbledhje të
4 propozuar për këtë dëshmitar për t'u pranuar sipas rregullës
5 154. Ne nuk kemi marrë ndonjë kundërshtim për sa i takon
6 procedurës dhe përmbledhjes së propozuar, kështu që në qoftë
7 se do të më lejonit, do të vazhdoj me leximin e përmbledhjes
8 për këtë seancë në seancë të hapur.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

10 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Në korrik të vitit 1998,
11 Claude Cahn ka punuar për Qendrën për të Drejtat Evropiane
12 Rome, të quajtur me akronimin ERRC. Gjatë punës së tij, Cahn
13 ka vizituar Kosovën, pjesën veriore dhe jugore të saj, nga
14 data 2 deri më 7 korrik të vitit 1999, ku ka intervistuar
15 romë, viktimë të krimeve, përfshirë këtu edhe shumë romë që
16 ishin të ndaluar nga anëtarët e UÇK-së. Cahn ka mësuar nga të
17 intervistuarit që ishin ndaluar nga anëtarë të UÇK-së që ishin
18 dërguar në vende të ndryshme në Prizren dhe përreth Prizrenit,
19 ku janë mbajtur të burgosur kur janë marrë në pyetje, ku janë
20 rrahur, kërcënuar dhe të akuzuar se ishin bashkëpunëtorë
21 serbë.

22 PY. Tani kam disa pyetje për ju. Në intervistën që i keni
23 dhënë ZPS-së keni thënë që keni intervistuar shumë romë në
24 zonën e Prizrenit dhe ju thoni, dhe citoj këtu, që: "Nuk ishte
25 e vështirë që të gjeje njerëz për të intervistuar. Në zonë nuk

1 ishte e vështirë që të bisedoje me njerëz dhe kishte viktima
2 të ndryshme të cilat na janë sjellë neve. Në veçanti në zonën
3 e Mëhallës Terzi”.

4 Ju thoni më pas që ju kujtohet që shumë të intervistuar
5 ju kanë treguar lidhur me ndalimin, marrjen në pyetje dhe
6 rrahjen nga UÇK-ja.

7 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Për procesverbal, ky
8 dokument është marrë nga prova materiale P1047, paragrafi 39.
9 PY. Dua që të përqendrohemi nga këta -- te këta të
10 intervistuar, domethënë, këta romë që ishin ndaluar nga
11 pjesëtarët e UÇK-së dhe personat e tjerë romë me të cilët keni
12 biseduar. Për shembull që mund të kenë qenë anëtarë familjesh,
13 miq apo komshinj të romëve të ndaluar.

14 A mund të përshkruani se çfarë ndikimi ka pasur ndalimi
15 dhe abuzimi, dhe çfarë niveli abuzimi kanë vuajtur personat të
16 cilët ishin ndaluar dhe me të cilët keni biseduar?

17 PË. Njerëzit ishin të shokuar. Ishin në faza të ndryshme
18 traume. Shumë prej tyre kishin lëndime të dukshme fizike që
19 mund të shiheshin me sy, kështu që nuk ishte e vështirë që të
20 kuptohej që -- pse ishin në atë nivel stresi që ishin.

21 Intervistat që kemi organizuar në Terzi Mëhallë kanë qenë
22 në ditët e para të realizimit të intervistave për ne -- prej
23 nesh, ose kanë qenë ditët e para. Ndoshta jo dita e parë fare,
24 por ndërmjet ditëve të para. Ne mund të shikonim edhe
25 pjesëtarë të tjerë të komunitetit, dhe ishte e qartë për ne që

1 edhe pjesëtarët e tjerë të komunitetit ishin shumë të
2 shqetësuar si rezultati i situatës së krijuar. Kështu që me
3 pak fjalë, më duhet të them që ishte një vend shumë i
4 stresuar.

5 Në kuadër të së njëjtës -- të të njëjtit mision, ne
6 mësuam që ajo zonë konsiderohej si zonë e sigurt kështu që
7 kishte njerëz që vinin nga zonat përreth dhe ishin vendosur
8 aty, dhe kishte dy ushtarë të KFOR-it në vende që dukeshin dhe
9 në fakt në atë pjesë, në atë lagje, vetëm aty kemi parë
10 pjesëtarë të KFOR-it, aty konsiderohej si vend i sigurt, siç e
11 thash edhe më përpara.

12 PY. Ju thatë që njerëzit ishin në nivele të ndryshme traume.
13 Si do ta përshkruanit gjendjen mendore të personave të
14 ndryshëm me të cilët jeni takuar?

15 PË. Të stresuar, të shokuar, të traumatizuar dhe këta ishin
16 persona që na kanë dërguar edhe te persona të tjerë të
17 traumatizuar, se ishin persona që i kishin anëtarët e familjes
18 diku tjetër, kështu që ishte e dukshme që ishin të frikësuar,
19 të traumatizuar. Ishin në shok për anëtarët e tjerë të
20 familjes. Kështu që ishin vërtetë njerëz të traumatizuar.

21 PY. Tani, të bëjmë një hap pas, në raport me këta individët
22 që keni pasur mundësi që të flisni. Çfarë mund të na thoni sa
23 i takon mjedisit atje. Domethënë, t'i lemë njerëzit mënjane
24 për një moment.

25 PË. E keni fjalën për atë lagje apo jo?

Dëshmitari: Claude Cahn (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 120

1 PY. Dua që të përqendrohemi më shumë te ndonjë individ me të
2 cilin keni biseduar dhe që ishte ndaluar nga UÇK-ja.

3 PË. Ne kemi qenë në vende ku njerëzit ishin rrëmbyer nga
4 shtëpitë e veta, ku shtëpive u ishte vënë flaka. Në një vend e
5 takonim dikë dhe pastaj mbas dy ditësh e takonim diku tjetër,
6 se njerëzit largoheshin. Mendoj që të gjithë ishin të
7 përgatitur që të largoheshin dhe po përgatiteshin që të
8 lëviznin sepse ishte një situatë shumë anarkike, situatë
9 anarkie e vërtetë. Ishte situatë e dhunshme. Për shembull,
10 shikoje persona të armatosur që ishin në traktorë që vozisnin
11 nëpër lagje. Kishte njerëz që kërkonin mbrojtje. Pra, kishte
12 ndryshuar regjimi, kishte një pushtet të ri. Të gjithë ishin
13 në dijeni të kësaj gjëje. Njerëzit po mundoheshin që të
14 përshtateshin. Ishte një vend që dukej sikur kishte humbur të
15 gjithë rendin, të gjithë civilizimin, gjithë strukturën që
16 mund të kishte pasur ndonjëherë, dhe dhuna ishte shumë e
17 prekshme. Shtëpitë sulmoheshin gjatë natës.

18 PY. Faleminderit. Nuk kam pyetje të tjera për ju, dëshmitar.

19 Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli:

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

21 PY. Faleminderit. Dëshiroj që të kalojmë te raportet tuaja me
22 goxha hollësi, në qoftë se ndonjëherë nuk e keni problem këtë
23 gjë, z. Dëshmitar. Vetëm një çast. Në raportin e shkruar prej
24 jush "Drejtësia për Kosovën" ju thoni që në vitin 1999 Serbia
25 e ka pezulluar statusin e autonomisë, në kuadrin e ish-

1 Jugosllavisë. Në këtë kontekst, ju thoni që shqiptarët etnikë
2 u hodhën në rrugë nga administrata kosovare dhe këtu
3 përfshihej, për shembull, heqja nga puna e shqiptarëve të
4 Kosovës nga pozitat e ndryshme, qofshin ato në institucionet
5 ekonomike apo politike, ndërmarrje të zotëruara nga shteti,
6 shërbimi civil, përfshirë këtu policinë, prokurorinë,
7 gjyqësorin, median, shëndetësinë, arsimin, e të tjera, apo jo?
8 Është kështu, apo jo, Dëshmitar?

9 PË. Po, unë nuk jam historian vetë, pra, burimi i njohurisë
10 sime vjen nga literatura e dorës së tretë që është e
11 disponueshme në gjuhët që unë flas këtu. Megjithatë, ishte --
12 domethënë unë këtë njohuri e kam nga literatura e dorës së
13 tretë. Nuk jam një historian, siç mund të ishte Tim Judah, për
14 shembull. Megjithatë e di që numri i romëve intelektualë që ka
15 qenë në atë zonë -- dhe kam dëgjuar edhe rrëfimet dhe
16 historitë e tyre sa i takon kësaj gjëje --

17 PY. Në artikullin tuaj ju keni përdorur një fjalë specifike.
18 Pse e keni përdorur këtë fjalë?

19 PË. Mendoj që në atë kohë, në ish-Jugosllavi ka pasur shumë
20 përpjekje për të shpjeguar -- pra për të shpjeguar se çfarë po
21 ndodhte. Dhe për shumë jugosllavë dhe për shumë nga ata që
22 shpjegonin -- pra përfshirë këtu edhe historianët, dhe këta që
23 merren me shkencat politike, pra -- kjo është një gjuhë që ka
24 filluar që të përdoret nga Slobodan Milosheviqi dhe nga
25 autoritetet jugosllave. Pra di shumë ekspertë të cilët kanë --

Dëshmitari: Claude Cahn (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 122

1 janë të njëjtës mëndje. Domethënë, termi i përdorur ishte
2 "dëbim". Pra kërkohej që të dëboheshin shqiptarët gjatë asaj
3 kohe.

4 PY. Në rregull. Le ta lexojmë ndoshta të gjithë paragrafin,
5 të gjithë pjesën, për ta pasur pak më të qartë se për çfarë
6 flitet.

7 Pra, kur ndodhi dëbimi, shqiptarët etnikë u zëvendësuan
8 nga persona të cilët ishin besnikë ndaj regjimit. Që ishin
9 serbët dhe romët. A është e vërtetë kjo, Dëshmitar? Dhe pastaj
10 ju vazhdoni më tej dhe thoni që gjatë gjithë viteve '90,
11 domethënë pas kësaj periudhe, romët e kanë mbështetur regjimin
12 e Milosheviqit në disa demonstrata e gjetkë.

13 PË. A mund t'i përgjigjem?

14 PY. Kjo është një pjesë e marrë nga artikulli që keni
15 shkruar.

16 PË. Pra, dua që të them që unë e kam fjalën këtu për disa
17 intelektualë romë, jo për të gjithë intelektualët romë.

18 PY. Mirë, në rregull, sa i takon shqiptarëve të Kosovës pas
19 viteve 1989. Besoj që ju pajtoheni me mua, të paktën mbi bazën
20 e kësaj çfarë po thoni, çfarë keni shkruar këtu, që romët dhe
21 serbët i kishin marrë punët atyre dhe që publikisht e
22 mbështesnin regjimin e Milosheviqit në atë kohë. Domethënë,
23 kjo ishte pak a shumë përshtypja e personave të zakonshëm, apo
24 jo?

25 PË. Nuk do të thosha kështu. megjithatë, mund të thosha që

1 kishte disa persona që numëroheshin me gishtat e dorës, në
2 rastin e romëve, të cilët gjendeshin në këtë situatë. Pra
3 persona të cilëve u ishin marrë punët dhe që u zëvendësuan pas
4 lëvizjeve të shumta që çuan në heqjen e autonomisë së Kosovës,
5 nga fundi i viteve '80.

6 Megjithatë, kishte romë që ishin të orientuar drejt
7 shqiptarëve, që ishin mbështetës të shqiptarëve. Gjithsesi,
8 për personat që ishin në zona urbane mbase kontakti i
9 drejtpërdrejtë i mundshëm me komunitetin rom ishin vendasit që
10 nuk kishin asnjë lidhje fare politike, dhe thjesht po
11 mundoheshin që të orientonin jetën e tyre, pra, që të gjenin
12 veten e tyre ndërmjet kësaj beteje, si me thënë, apo
13 përplasjeve ndërmjet dy komuniteteve më të mëdha.

14 PY. E kuptoj. Tani dua -- thjeshtë po ju citoja. Mbase është
15 më mirë qa të nxjerrim në ekran këtë dokument.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Është prova materiale me numër
17 P1054. Është në faqen 023816.

18 PY. Pra, në paragrafin e parë. Mund ta shikoni. Po citoj nga
19 ajo që keni shkruar ju, që shqiptarët etnikë u spastruan nga
20 administrata dhe u zëvendësuan me ata që ishin besnikë të
21 regjimit. Si rezultat i kësaj, romët pësuan, ose u bënë objekt
22 i armiqësisë të kauzës nacionaliste shqiptare.

23 PË. Mund të përgjigjem? Ju po citoni një pjesë të shkurtër
24 nga ndonjëherë një artikull më të gjatë. Është një pjesë e
25 tekstit që përpiqet të shpjegojë pikërisht konfliktin që

1 ekzistonte në politikën e viteve '90. Nëse më pyesni sot se
2 cili është burimi i armiqësive ndaj romëve, ashkelive,
3 egjiptianëve, e të tjerëve, mbase burimi -- me shumë gjasë,
4 është shumë më i thellë. Një racizëm dhe përjashtim social që
5 mbase mori flakë, mori shkëndijë duke vendosur në objektiv --
6 pra, mori shkëndijë, le të themi kur personat të cilët
7 konsiderohen si të përjashtuar nga shoqëria ngrihen në pozita
8 më të larta. Nuk është se nuk i qëndroj këtij paragrafi, por
9 është pjesë e një paragrafi më të gjatë.

10 Po përshkrimi, siç e shihni këtu, është "më së shpeshti",
11 pra romët, ku ishin midis zjarreve, pra përpiqeshin
12 vazhdimisht, është një përpjekje e vazhdueshme që të jetonin
13 mes dy bashkësive, të cilat ishin në konflikt me njëra
14 tjetrën. Dhe është e vështirë që në raste të tilla që të jesh
15 komplet i asnjansës.

16 PY. Pra, pas këtij spastrimi të shqiptarëve të Kosovës besoj
17 është e vërtetë që gjatë viteve '90 pësuan diskriminim dhe një
18 përkeqësim -- pati përkeqësim të armiqësisë ndaj romëve të
19 cilët tani kishin marrë punët e tyre.

20 PË. Ju po më pyesni tani përtej asaj që unë di?

21 PY. Po a është e vërtetë që çdo armiqësi ndaj romëve në këtë
22 kohë do të përkeqësohej nga diskriminimi historik ndaj romëve
23 në Kosovë por edhe në rajon më gjerë? Nuk e di nëse mund të
24 jetë përgjigje e kësaj?

25 PË. Ju lutem përsërisni pyetjen.

1 PY. Pra, pyetja ka të bëjë me diskriminimin historik gjatë
2 dekadave. Pra çfarëdolloj diskriminimi, armiqësi ndaj romëve
3 në këtë periudhë do të jetë përkeqësuar edhe nga diskriminimi
4 historik kundër romëve?

5 PË. Po, jam dakord me këtë që thatë ju. Pajtohem. Do të
6 shtoja madje se shumë romë -- intelektualë romë dhe jo romë e
7 perceptonin Jugosllavinë shumëkombëshe si një familje ku
8 kishte frikë dhe ku nuk u besohej nacionalizmave të ndryshme.
9 Kishte një farë besnikërie ndaj Beogradit si simboli i
10 Jugosllavisë, jo si simboli i nacionalizmit, sepse Jugosllavia
11 kishte -- pra që në vitet '70 -- '60 -- promovonte romët në
12 media në gazeta, duke filluar kështu për herë të parë në
13 histori që jeta e romëve u ngrit në një barazi politike dhe
14 ekonomike. Prandaj dhe kishte një besnikëri kaq të fortë nga
15 bashkësia romë ndaj idesë jugosllave.

16 PY. Faleminderit. Në raportin tuaj me titull "Drejtësi për
17 Kosovën" ju cekni zbatimin e planit të Milosheviqit të quajtur
18 "Patkoi" që filloi që në vitin 1999. Dhe kjo shikohet
19 gjerësisht si një fushatë spastrimi etnik dhe dhunë në masë
20 kundër popullsisë me kombësi shqiptare nga ana e forcave serbe
21 që i përzunë këta nga Kosova. Kështu besoj lexohet kjo.

22 PË. Pyetje? Është pyetje?

23 PY. Jo, po përpiqem që të konstatoj njëherë cili është
24 konteksti. Janë rregulla këto që ndjekim.

25 PË. Unë kam ndjekur -- kam ndjekur lajmet, sigurisht në

Dëshmitari: Claude Cahn (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 126

1 media, dhe ka me qindra e mijëra vetë të cilët kanë shkuar në
2 Shqipëri e Maqedoni. Por kjo është e vërtetë që thoni ju.
3 PY. Që të jemi të qartë, unë nuk po them që nuk janë të
4 vërteta, por thjesht kemi një renditje logjike të pyetjeve,
5 por tani do bëjmë ca pyetjet të tjera. Jemi të detyruar që ta
6 bëjmë këtë. Pra a do të pajtoheshit me mua, pra që statistikat
7 e OSBE-së dhe të UNHCR-së asokohe që gjithsej ishin 863 mijë
8 shqiptarë të Kosovës të cilët u bënë objekt i zhvendosjes
9 asokohe, dhe UNHCR-ja çmonte se edhe 59 mijë persona të tjerë
10 pësuan zhvendosje të brendshme në Shqipëri.

11 PË. Pajtohem me këto statistika, por ka një kusht në këto.
12 Asokohe UNHCR-ja dhe OSBE-ja nuk po ndiqnin, s'po monitoronin
13 kombësinë e personave të zhvendosur. Më pas u pranua që brenda
14 këtyre shifrave kishte edhe romë, të cilët ishin pjesë e kësaj
15 zhvendosjeje të popullsisë shqiptare por nuk quheshin si romë.
16 Pra ishin të përfshirë në këto shifra.

17 PY. Faleminderit. Jo, për shifrën e fundit e kisha - 595
18 mijë. E thashë gabim.

19 PË. Po në rregull, pa problem. UNHCR-ja pra sigurisht nuk
20 është se po ndiqnin - nuk është se mbanin shënim kush ishin
21 shqiptarë, me kombësi shqiptare, kush ishin me kombësi rome,
22 ashkali, e kështu me radhë. Por kjo -- këto shifra përfshinin
23 një gamë më të gjerë kombësish.

24 PY. Pra, besoj se këtë operacionin "Grenxa" --

25 PË. Jo, operacioni "Potkoi".

1 PY. Më falni, operacioni "Patkoi", pra, kishte të bënte me
2 forcat serbe që digjnin plaçkitnin prona, ekzekutonin njerëz,
3 ka histori për përdhunime, e kështu me radhë, për ta shtyrë
4 popullsinë që të largohet. Kështu është?

5 PË. Kjo shkon përtej ekspertizës sime. Kam lexuar raportet,
6 sigurisht, i di që kanë ekzistuar këto por --

7 PY. Ju gjithashtu keni thënë në raportin tuaj "Drejtësi për
8 Kosovën" se në operacionin "Patkoi", "romët dhe të tjerët të
9 konsideruar si ciganë në Kosovë kanë luajtur rol. Romët e kanë
10 ndihmuar policinë për plaçkitjen e dyqaneve dhe për të zbatuar
11 aksionet e tyre, dhe kanë ndihmuar policinë që të varroste
12 edhe shqiptarët e vdekur".

13 Pajtoheni edhe me këtë? Edhe tani?

14 PË. Mendoj se kjo ka qenë një prej tipareve që të linte
15 përshtypje në dokumentacion, pra që këto përputheshin, por
16 interpretimi ishte ndryshe. Për shembull, romët thoshin që
17 vinte policia e serbëve në mëhallën e romëve, na merrnin me
18 vete nën kërcënimin e armës, na thoshin që "ejani me ne, do të
19 shkojmë nëpër dyqane" dhe na urdhëronin që të merrnin gjërat
20 me vete. Ose i merrnin burrat romë që të varrosnin kufomat.

21 Kjo është siç e thanë romët. Pastaj po të dëgjoje
22 shqiptarët, shqiptarët thoshin që romët kanë bërë punën e
23 pisët të serbëve. Pra në një farë mënyre, kishte një përputhje
24 në fakt midis asaj që thoshin romët, se çfarë kanë bërë gjatë
25 kësaj periudhe kohore, sidomos nga shkurti deri në qershor,

1 por interpretimi ishte krejt ndryshe.

2 Pra, ajo që dëgjoje nga shqiptarët është që romët kanë
3 marrë anën e palës tjetër, ndërkohë që romët thoshin që na
4 kanë detyruar. I kishin detyruar që t'i bënë ato punë.

5 Hapi i dytë që vjen pas kësaj është që më pas, kur ke
6 persona të zhvendosur, për shembull në Maqedoni, të cilët nuk
7 ktheheshin dot në shtëpi sepse fakti që ishin larguar nga
8 vendi, krijonte dyshime se mos kishin bërë ndonjë gjë të keqe.
9 Në sy të tjerëve, flasim, gjatë ngjarjeve, për faktin që ishin
10 larguar, të paktën në sy të fqinjëve shqiptarë, kishin frikë
11 se mos ngjanin se kishin qenë bashkëpunëtore gjatë operacionit
12 "Potkoi". Por, sa i takon asaj që ka ndodhur gjatë asaj
13 periudhe -- pra nuk është se kishte mospërputhje midis fakteve
14 të raportuara, por kishte dallim të madh në interpretim.
15 PY. Arsyeja përse e kam bërë mund të debatohet, sigurisht,
16 sepse ka interpretime të ndryshme. Por rezultati neto të
17 themi, siç e thoni edhe ju në raport, është që shqiptarët e
18 zakonshëm e konsideron të gjithë këtë, pra faktin që sapo
19 thatë, si provë, dëshmi e faktit se romët kishin -- ishin
20 lidhur në aleancë të themi me ata të cilët shqiptarët i
21 konsideronin ai okupatorë. Pra ju thoni "si armiq të kombit
22 shqiptar".

23 PË. E kanë tradhtuar kombin shqiptar, por fjala aleancë nuk
24 më duket se është rasti për t'u përdorur, pra nuk është se
25 ishte një farë besnikërie.

1 PY. Po, kërkoj ndjesë, se keni thënë "kanë tradhtuar kombin
2 shqiptar". Por si rezultat i kësaj, mund të thuhet që
3 shqiptarët -- shqiptari i zakonshëm nuk i shihte me sy të mirë
4 romët në atë kohë.

5 PË. Absolutisht kështu. po.

6 PY. Dhe besoj se kjo duket qartë në intervistën që ju keni
7 bërë me SITF-në, me Task Forcën Hetimore të Posaçme, kur --
8 lidhur me një prej viktimave romë, kur keni thënë që
9 shqiptarët -- që mjekët shqiptarë ose nuk i kuptonin mirë, ose
10 nuk kishin ndonjë simpati për romët. Dhe ju jeni shprehur që
11 ju ka acaruar kjo frikë ndaj romëve dhe keni thënë në një
12 raport tjetër që mjeku i ka thënë romëve që -- i ka thënë që -
13 - i ka thënë romes që "nëse të kanë rrahur, duhet ta kesh
14 merituar".

15 Pra del qartë, ju e keni parë vetë me sytë tuaj që kjo
16 ndjesi armiqësore ndaj romëve ishte shumë e përhapur në
17 shoqërinë shqiptare të Kosovës asokohe.

18 PË. Po, pajtohem me këtë plotësisht, por dua të shtoj diçka
19 nëse mundem. Është po kështu e vërtetë se publiku sikur donte
20 të na pengonte që të punonim me romët. Pra sikur -- ishte një
21 si lloj mafia, të themi në përgjithësi, si një lloj
22 organizimi.

23 PY. Kjo s'kishte të bënte me UÇK-në. Ishte një ndjesi që
24 ekzistonte në të gjithë shoqërinë, pra nuk duhej të ishte
25 medoemos anëtari i UÇK-së që të kishe këto lloj ndjenja ndaj

1 romëve, apo jo?

2 PË. Është përtej dijenive të mia tani të di lidhjet midis --
3 sesi antipatia mund t'i transportohej bashkësisë nga UÇK-ja,
4 por është po kështu e vërtetë që shumë njerëz po bënin gjëra
5 të këqija në baza etnike.

6 PY. Nëse mund të ecim përpara, në 10 qershor të vitit 1999
7 rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së me numër 1244,
8 miratohet dhe kjo rezolutë ngre edhe UNMIK-un ku -- që është
9 Administrata e Përkohshme Civile Ndërkombëtare për Kosovën,
10 dhe në detyrat e tyre përfshihet edhe ruajtja e rendit dhe e
11 shtetit ligjor, përfshirë edhe ngritjen e forcave policore
12 lokale -- po lexoj nga kjo: Mbrojtjen dhe promovimin e të
13 drejtave të njeriut dhe sigurimin e kthimit pa pengesë të të
14 gjithë refugjatëve dhe personave të larguar nga shtëpitë e
15 tyre.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Për procesverbalin, është prova
17 materiale me numrin 1D.

18 PY. Është edhe rregullorja e UNMIK-ut, që është prova 1D0079,
19 që parashikonte autoritetin legjislativ dhe administrativ për
20 të gjithë Kosovën, përfshirë edhe kompetencat që i jepen
21 UNMIK-ut dhe ushtrimet e këtyre kompetencave nga përfaqësuesi
22 i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm. Edhe një herë po
23 vendos kontekstin për pyetjet që do ua bëj më vonë. Rezoluta e
24 Këshillit të Sigurimit me numrin 1244 parashikonte edhe
25 krijimin e KFOR-it, dhe në detyrat e tyre përfshihej edhe

1 sigurimi i mbrojtjes së publikut dhe e rendit publik, gjersa
2 prania e bashkësisë ndërkombëtare të mund ta merrte përsipër
3 realizimin e kësaj detyre.

4 Kur ju ndodheshit aty, nga data 2 deri më 7 korrik të
5 vitit 1999, as UNMIK-u, as KFOR-i nuk i kishin burimet si në
6 njerëz ashtu edhe në mjete për të mbrojtur sigurinë dhe rendin
7 publik në terren, kështu?

8 PË. Mund t'i përgjigjem kësaj pyetje vetëm nga këndvështrimi
9 i asaj se çfarë po ndodhte në Prizren, Gjakovë, dhe një qytet
10 tjetër, por kam edhe -- di edhe metodën që kanë thënë edhe
11 ekipet e tjera, që kanë shkuar në Prizren, Rahovec e kështu me
12 radhë.

13 PY. Më mirë atë që dini ju.

14 PË. Përshtypja që kishim ne, siç është thënë qartë edhe nga
15 komanda gjermane, që nuk ish -- ato nuk i kishin burimet e
16 njerëzve apo të mjeteve për të siguruar mbrojtje. Këtë ma ka
17 thënë direkt komandanti. Komandën italiane s'e kemi takuar
18 asnjëherë në Gjakovë. Kishte thashetheme -- qarkullonin zëra
19 se ishin shumë të afërt me UÇK-në, pra bënë më pak përpjekje,
20 të themi. Nuk jam takuar me atë.

21 Këto janë zëra që qarkullonin për copëtime nga kolegët në
22 zonën franceze dhe britanike, që kishin ndjesinë që kishin
23 burimet, por kishin urdhër që të mos ndalonin plaçkitjet.
24 Ishte një lloj ndjesie në veçanti se britanikët kishin përvojë
25 në Irlandën e Veriut, ishin më të aftë për të bërë një lloj

Dëshmitari: Claude Cahn (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 132

1 policimi të tillë, por u ishte thënë, si të thuash, që t'i
2 linin këto plaçkitje të vazhdonin. T'i toleronin. Këto m'i
3 kanë thënë kolegët në Prishtinë.

4 PY. Po, e keni shpjeguar me hollësi këtë në raport. Është kjo
5 e oficerit gjerman. S'do përpiqem t'ia shqiptoj emrin, se
6 s'di, por ju tha se nuk ishin burime në njerëz për të siguruar
7 mbrojtje në shumicën e qyteteve dhe në thelb, s'kishin gjë në
8 dorë për të ndaluar plaçkitjet gjatë natës dhe dhunën. Dhe ju
9 keni shkruar, apo jo? I jeni drejtuar me letër Kofi Ananit,
10 Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së asokohe, kemi një kopje
11 të kësaj letre në artikullin tuaj që është pjesë e provës
12 materiale me numër P1062, dhe fraza juaj është që njësitë
13 policore civile janë të -- kanë numër të pamjaftueshëm njerëz
14 dhe janë jo efektive.

15 PË. Është pyetje kjo?

16 PY. Jo, po përpiqem të vendos kontekstin për të krijuar një
17 ide sesi ishte situata atëherë.

18 PË. Këtë na e ka thënë komandanti i forcave gjermane dhe ai
19 ka bërë çmos. Për shembull, dërgoi një ekip që të shpëtonte
20 një grua, ishte me ne. Ne e pamë pra, se si funksionon ushtria
21 gjermane. Ishin 18 -- ushtarë tetëmbëdhjetë vjeçarë, pa
22 përvojë. Nga këta s'kishte të mjaftueshëm. Nëse nuk e kam
23 gabim, është angazhimi i parë gjerman ushtarak jashtë
24 Gjermanisë pas Luftës së Dytë Botërore. Kështu që nuk kishin
25 përvojën, personelin, mjetet.

Dëshmitari: Claude Cahn (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 133

1 PY. A ishit ju në dijeni asokohe se këto probleme sa u takon
2 burimeve u ngritën edhe nga përfaqësuesi i posaçëm i
3 Sekretarit të Përgjithshëm i UNMIK-ut?

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Është materiali -- prova
5 materiale me numër 1A00081. Është një shkresë që e dërgon
6 Bernard Kouchner lidhur me punët policore të UNMIK-ut. Është
7 faqja e dytë, në pjesën e sipërme. Kjo është.

8 PY. Pra ishit ju në dijeni që ai e kishte ngritur këtë
9 problem dhe vëren këtu që:

10 "Fuqia e autorizuar aktuale e policisë së UNMIK-ut është
11 1800, që do të thotë është një raport një polic policie për
12 909 shtetas..."

13 Ndërkohë që raportet tipike evropiane policore janë, dhe
14 në bazë të këtyre, pra:

15 "Një raport i tillë, pra një për 909 është krejt i
16 pamjaftueshëm për ruajtjen e rendit."

17 A kishit dijeni për këtë?

18 PË. Mund ta kem lexuar, mbase. Ka 25 vjet, s'më kujtohet
19 tani.

20 PY. Verën e vitit 1999 serbët ishin larguar. UNMIK-u me ritëm
21 të ngadaltë po rifillonte dhe KFOR-i nuk i ka burimet, nuk i
22 paska pasur burimet. Pra a do të pajtoheshit me mua që
23 rezultati do të thotë ishte -- një zbrazëti sa i takon rendit
24 publik dhe shtetit ligjor.

25 PË. Shumë serbë ishin larguar, jo të gjithë serbët.

1 PY. Kur thashë "serbët", e kisha fjalën qeveria serbe,
2 policia e serbëve.

3 PË. Po, me përjashtim të Mitrovicës, po. Kjo është e vërtetë.
4 Kishe ndjesinë e anarkisë, po kemi parë që UÇK-ja ka ushtruar
5 atë që në dukje ishte autoritet, pushtet ushtarak. Sidomos në
6 një rast e kemi parë ku personat të cilët -- ku po qëndronim
7 ne, shkuan te UÇK-ja dhe pyetën, a ishte në rregull që të
8 qëndronin apo jo dhe erdhën edhe ata dhe e panë shtëpinë. Pra
9 në një rast e kemi parë praninë e dukshme të UÇK-së si
10 autoritet.

11 Më duket edhe një herë tjetër isha ulur në verandë dhe
12 dikush po intervistonte një person me një uniformë të UÇK-së,
13 pra kishte shenja të pranisë së UÇK-së në formë pushteti.

14 PY. Po ju e dinit, megjithatë, që ligjërisht nga 10 qershori,
15 pushteti është Kosovë i ishte transferuar, kaluar pra,
16 bashkësisë ndërkombëtare. Kështu është?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe sa i takon pyetje se kush është UÇK-ja, në veprën
19 tuaj në punët tuaja, në blloqet tuaja ka prova se ka dëshmi të
20 romëve, viktimave të krimit, dhe disa prej tyre i ke
21 përshkruar kryerësit e krimit që ishin shqiptarë të veshur me
22 tesha civile. Kështu është?

23 PË. Po, kështu është.

24 PY. I kam nja dy shembuj. Keni intervistuar një person më
25 duket, që thanë që shqiptarë jo të veshur me uniformë që e ka

1 bërë këtë. Një tjetër pastaj ka thënë "jo të veshur me
2 uniformë". Një kishte një kapë të firmës NIKE dhe kishte dhe
3 disa persona të veshur me uniformë të UÇK-së.

4 Pra në këto qindra shënime intervistash -- në një prej
5 këtyre shënimeve tuaja për të shkruara me dorë, pra, të
6 intervistës - të intervistës që e keni bërë me një viktimë,
7 është me numër P149, faqe 46, viktima thotë:

8 "Tani shqiptarët -- çdo shqiptar mund të vishet si UÇK me
9 30 deutschmarka."

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të thoni
11 po ose jo.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Më duket se e nderuara avokate po
13 citon diçka nga blloqet e mia të shënimeve. Kam shkruar çfarë
14 më kanë thënë.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]
16 PY. Ishit ju në dijeni, pra, që kjo mundësi për të bë blerë
17 një uniformë të UÇK-së me - i është bërë jehonë edhe në një
18 dokument tjetër të Komisionerit të OKB-së për të drejtat e
19 njeriut, ku thuhet se doku -- një ushtar -- uniformë e tillë e
20 gjen për 50 marka gjermane.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Është në provën materiale me
22 numër 1D85 [Sipas përkthimit], paragrafi 102.

23 PY. Është fjalia e fundit. Ju e kishit parë këtë, që
24 Komisioneri i Lartë kishte zbuluar po këtë që kishit zbuluar
25 dhe ju që uniformat e UÇK-së mund t'i gjeje, shiteshin.

Dëshmitari: Claude Cahn (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 136

1 PË. S'më kujtohet që ta kem parë këtë raport, por është e
2 mundshme që ta kem parë atëherë.

3 PY. Po në bazë të kësaj, mund të themi -- jo, do ta them
4 ndryshe. Do t'i kthehem.

5 Gjatë kohës që ju ndodheshit aty, kemi konstatuar tashmë
6 që kishte shumë shqiptarë që ishin larguar nga vendi --

7 PË. Shqiptarë që ishin larguar deri në verë?

8 PY. E kam fjalën 863 mijë kosovarë ishin larguar.

9 PË. Besoj se konsensusi është që shumica e këtyre u kthyen
10 shumë shpejt. Madje u kthyen aq shpejt sa që nuk menaxhoheshin
11 dot nga UNHCR-ja.

12 PY. Pra, këtë desha të them, kthehen në Prizren OSBE-ja --
13 nuk e di nëse kjo reflekton atë që keni parë ju. OSBE-ja ka
14 raportuar se në Prizren gjatë kësaj kohe shifrat e mëparshme
15 tregonin se 15-30 mijë refugjatë ktheheshin çdo ditë pas
16 konfliktit.

17 PË. Nuk e di këtë shifër, s'kemi punuar, s'jemi marrë me
18 këtë.

19 PY. Po kishte shumë njerëz. A keni parë ju me sytë tuaj shumë
20 njerëz?

21 PË. Ndërkombëtarët më kanë thënë që njerëzit po ktheheshin me
22 ritme shumë të shpejta nga sa mund t'i përballonin, por nuk
23 është se i kam parë. Nuk është se i kemi marrë me këtë punë që
24 t'i kemi vënë re.

25 PY. Besoj se keni folur me disa nga persona nga UNHCR-ja për

1 të biseduar për rikthimet e romëve. Pra ju u përgjigjët se
2 ishte shumë e ngarkuar për faktin që po ktheheshin shumë
3 shqiptarë. Ju kujtohet kjo? Ka ndodhur kjo?

4 PË. Po, ky është burimi kryesor im i informacionit. Një
5 bisedë që kam pas me UNHCR-në.

6 PY. Mbase nuk është ekspertiza juaj, por shumë nga këta
7 refugjatë që po ktheheshin, po vërshonin drejt Kosovës, kur u
8 rikthyen panë që shtëpitë u ishin djegur, u ishin vjedhur,
9 pajisjet, plaçkat e tyre dhe u ishin vrarë familjarët dhe
10 shokët e tyre. Dhe u ka ndodhur në një kohë kur s'kishte
11 polici as vendase dhe as ndërkombëtare. A është kështu?

12 PË. Nuk kam burim të drejtpërdrejtë për këtë. Thjesht kam
13 lexuar raporte nga OSBE-ja pas faktit. Ajo që kam unë -- unë
14 nuk kam parasysh shkatërrimin dhe rindërtimin e shtëpive rome
15 -- roma në shtëpi, ku nuk ka pasur -- kur nuk kishte më në --
16 komunitete rome, sepse personat shumë shpejt i shkatërruan të
17 gjitha gjërat dhe pastaj u rindërtua e gjithë situata shumë
18 shpejt në vitin 1999, por ne nuk kemi dokumentuar situatën e
19 shqiptarëve kështu që nuk kam burim të drejtpërdrejtë në
20 lidhje me këtë.

21 PY. Por ama kur u kthyen këta refugjatët, a është kështu? Në
22 kufi pati edhe një valë dhune në Kosovë. Sepse u ishte --
23 situata ishte anarkike. Ju e përshkruani si një anarki
24 momentin kur po ktheheshin shqiptarët. Dhe besoj se keni folur
25 me një oficer gjerman të KFOR-it, i cili tha -- ju tha në

1 mënyrë jozyrtare se kishin ndodhur më shumë se 250 vrasje në
2 sektorin -- në pjesën që mbulonte KFOR-i gjerman. Dhe gati çdo
3 ditë ndalonin mes 30-100 personave në policinë -- 130-150
4 personave në policinë ushtarake në burgun e policisë ushtarake
5 të Prizrenit. Pra situata ishte kaotike, ndodhnin shumë vepra
6 penale.

7 PË. Po, hakmarrje, kishte dhunë, kriminalitet. Nuk e di nëse
8 fjala kriminalitet është fjala e duhur, por kështu. Po. Por
9 nuk kam një burim për këtë. Thjesht e kam lexuar nga palë të
10 treta.

11 Unë mund t'ju them si i morëm vesh ne informacionet që
12 kemi mësuar nga shkurti e në vijim, nëse ju ndihmon kjo.

13 PY. Jo, nuk është nevoja. Ju përmendët hakmarrjen. Po
14 ndodhnin shumë krime për shkak të hakmarrjes. Ju i keni
15 vrojtuar vetë krime të tilla, apo jo? Dhe besoj se ju i keni
16 thënë Prokurorit javën e kaluar kur po rishihnit dëshminë tuaj
17 bashkë me ta, se ishte prishur komplet rendi publik dhe se
18 kishte shumë keqbërës.

19 PË. A mund të flasim për fjalën "hakmarrje"? Kur po shkonim
20 në Gjakovë, po vozisnim në rrugë, dhe kishte një shtëpi që
21 digjej në buzë të rrugës. Ne ndaluam. Ishin tre adoleshentë që
22 i kishin vënë flakën shtëpisë. Ata ishin shumë të gëzuar dhe
23 na thanë "serbë të mirë, serbë të mirë".

24 Unë nuk e di nëse ata vetë kishin motiv hakmarrje, për
25 t'i -- për të larë hakun me dikë që u kishte bërë

1 drejtpërdrejtë diçka atyre. Po ishte një valë dhune nga
2 publiku kundrejt disa komuniteteve të caktuara. Prandaj
3 përkufizimi i fjalës "hakmarrje" në këtë kuptim, në kuptimin
4 që ti më bën diçka dhe unë marr hak, nuk është pikërisht kjo
5 situata.

6 PY. Po, mbase "anarki" do të ishte termi më i përshtatshëm që
7 të përdorej në këtë rast. Po ndodhnin shumë krime në të gjithë
8 vendin. Në mbarë vendin, zotëri.

9 PË. Po.

10 PY. Dhe në të vërtetë ju keni dokumentuar, dhe ramë dakord
11 për këtë -- ju e keni dokumentuar këtë dhe e keni thënë që
12 këtë e bënin civilët e thjeshtë, njerëzit normalë, shqiptarët
13 e Kosovës.

14 PË. Këtë pamë ne. Ne nuk bëmë asnjë përpjekje, dhe ne kishim
15 udhëzim të mos kontaktonim me UÇK-në, kështu që ne nuk do të
16 flisnim me disa autoritete ushtarake, ushtri të çrregullta. Ne
17 nuk do t'i kontaktonim, nuk i kërkonim këta. Nuk shkuam në
18 ndërtesën, në shkollën ku thuhej se mbanin persona të ndaluar.
19 Nuk do e bënim një turizëm të tillë kaq të rrezikshëm. Ne i
20 dokumentonim ato që shihnim dhe të merrnim dëshmitë e
21 personave që kishte të ngjarë të ishin abuzuar.

22 Nuk mund t'ju jap shumë detaje. Mund t'ju them vetëm për
23 atë që pashë. Pashë që civilët, publiku, digjnin shtëpi. U
24 vinin flakën shtëpive. Por nuk mund t'ju jap asnjë
25 përgjithësim shumë të madh se kush ishin këta persona. Pamë

Dëshmitari: Claude Cahn (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 140

1 persona civilë, pamë persona civilë që silleshin, sipas meje,
2 në një mënyrë shumë të çuditshme.

3 Ka qenë një komunitet rom që duhej të shkonim me taksi në
4 periferi të Prizrenit. Shkuam dy herë me taksi në këtë
5 komunitetin rom, dhe të dyja herët nuk e hiqnim dot qafe
6 shoferin. Dinte -- na komentonte për çdo gjë të mundshme se
7 çfarë thoshin romët. Por nuk ikte. Nuk ikte. Nuk lëvizte
8 vendi.

9 Unë nuk e di tani a ishte anëtar i UÇK-së apo jo ky
10 person, nuk di asgjë lidhur me këtë person, por mund t'i
11 shihje personat e publikut, civilët, që silleshin në mënyrë të
12 papërshtatshme. Kaos, anarki janë termat më të mirë për ta
13 përshkruar situatën. Praninë apo ekzistencën apo mos
14 ekzistencën e rendit publik.

15 PY. Dhe një arsye që pse nuk mund të thoni është se ju s'keni
16 folur me UÇK-në, por edhe sikurse thatë, mund të blije
17 uniformë të UÇK-së në treg. Gjendeshin kudo. Kështu që ishte e
18 vështirë të thoshe me siguri kush ishte, kush nuk ishte.

19 Kështu?

20 PË. Po. Por në një rast, kur mendoj që vërtetë se vërtetë kam
21 parë një anëtar të UÇK-së, ishte e qartë që persona me të
22 cilët kishim qëndruar, ishin drejtuar asaj që mendonin që
23 ishte Shtabi i UÇK-së. Ishin takuar me anëtarë të UÇK-së dhe
24 ishin kthyer me -- ishin kthyer në shtëpi me ata. Kështu që ne
25 nuk e kuptonim qartë dot kush ishin të UÇK-së, me përjashtim

1 të kësaj rrethane konkrete, por besoj që civilët, personat e
2 publikut, e dinin.

3 PY. Kur ishit atje, a e dinit ju që Hashim Thaçi në mënyrë të
